

#FESTAT DUAN DASHURI-SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR



Në 29 Qendra Përkujdesi në të gjithë vendin në datën 29 Dhjetor u zhvilluan aktivitete të ndryshme nën sloganin “Festat duan Dashuri”, dhe jo vetëm në këtë ditë por edhe përgjatë gjithë muajit Dhjetor donator të ndryshëm u vetëofruan për të dhuruar si nga ana materiale dhe nga ana shpirtërore duke u vendosur në pozitën e përfituesve në qendra të ndryshme të vendit.

Një falenderim i madh shkon për të gjithë ata që na mbështën dhe u gjendën pranë njerëzve më në nevojë si kompania Aluflor, Teleperformace Albania, Banka Bkt, Avokati i Popullit, Ojfi SFI, Zepa Natyral, studentët e Shkencave Sociale, nxënës shkollash, etj.

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË NE DHE PAK



Vijoi dhe gjatë muajit Dhjetor fushata kombëtare për informimin e qytetarëve për risitë e skemës të Ndhmës Ekonomike, në Vlorë, në Shkodër dhe Elbasan. U riinformuan qytetarët lidhur me skemën e re ku:

- Targetohen më të varfërit.
- Nuk ka kritere përjashtuese, çdo qytetar mund të aplikojë në skemë.
- Qytetarët përfitojnë pagesën e ndihmës ekonomike të plotë, jo më të pjesshme.

Nga 7 dokumente, sot aplikohet vetëm me dy dokumente.

Ndihma ekonomike është një ndihmë e përkohëshme për familjet në nevojë. Alternativa jonë është riintegrim nëpërmjet aftësimin profesional dhe punësimit. Këto ishin mesazhet që u përcollën tek qytetarët për të kuptuar qartë qasjen e skemës së re të ndihmës ekonomike.

#DREJTORIA E KOMISIONIT TË PAK



Gjatë muajit Dhjetor u zhvillua fushata e komunikimit për shtrirjen e modelit të vlerësimit bio-psiko-social nga kompania e kontraktuar nga MSHMS.

Kompania në bashkëpunim me SHSSH dhe DRSHSSH, organizuan 6 takime me punonjës sociale, punonjës të bashkive, mjekë. Takimet janë realizuar në Tiranë më datën 21 dhe datën 27 dhjetor, në Durrës më datë 24 dhe më datë 26 dhjetor dhe në Elbasan më datë 24 dhe 26 dhjetor.

Gjatë takimeve u prezantua procedura e vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar që po pilotohet aktualisht në njësitë administrative nr.6 dhe nr.7, Tiranë.

#RRISIM STANDARTET. 3 DHJETOR IPSH



Në Qendrën e Zhvillimit **#Durrës** në ditën ndërkombëtare të Aftësisë së Kufizuar për shërbimin e karrigeve me rrota **#falas** për personat me aftësi të kufizuar.

Punohet çdo ditë për më shumë për të pasur shërbime socio-shëndetësore por kemi ende shumë për të bërë për barazi dhe gjithëpërfshirje sociale për personat me aftësi ndryshe. Në këtë qendër dita ditës rriten shërbimet dhe standartet për ata persona që kanë nevoja specifike.

#HISTORI SUKSESI



Nga Shkodra gjatë muajit Dhjetor na kanë ardhur vetëm lajme të mira!

Falë kontributit dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit me OJF “The Door” të përfaqësuar nga Kastriot Faci, dy gjyshër kanë dy karroca në formë motorri që do t’ia lehtësojnë atyre dhe familjarëve lëvizjen në qytet, pas problemeve shëndetësore që ata kanë patur, gjë që kufizonte jetesën normale të këtyre zotërinjëve.

“The Door” janë mbështetës të vyer të grupeve në nevojë!